



Datë: 11.06.2025
Numër Protokolli: 4233/2025

A.nr.576/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.576/2025, të datës 01.04.2025, të parashtruar nga ankuesi B.M, kundër organit të punësimit: Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 11.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e papabazuar ankesa me numër A.nr.576/2025, e datë 01.04.2025, e parashtruar nga ankuesi B.M

A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.M, (*tutje referuar ankuesi*), më datë 01.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, më pretendimin që ky i fundit ti rekomandoj Qeverisë së Kosovës që pozitën e ankuesit “Zyrtar i Lartë për Siguri dhe Integritet të Rrjetave të Komunikimeve Elektronike, ARKEP, ta përfshij në nivelin e ekspert 4, më klase B4, me koeficient 14, sipas shtojcës 14.4 të Ligjit për pagat në sektorin publik, dhe Sistemin KOSIX (Nyjën Shkëmbyese të Internetit) ta përfshijë në listën e sistemeve strategjike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek ARKEP, ndërsa, kjo e fundit, më datë 22.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2161/2025 të datës 01.04.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emali nga B.M për Rr.D e datës 24.12.2024; Kërkesë nga ARKEP për komisionin e datës 26.12.2024; Kërkesë nga kryesuesi i ARKEP-it e datës 26.12.2024; Email nga B.M për R.K, A.Q, E.A; Kërkesë nga B.M e datës 25.02.2024 për R.K, A.Q, E.A; Akt emërim i datës 29.11.2024 me Nr.130/1/24; Emaili nga ankuesi e datës 27.03.2025 për N.R dhe I.I; Emaili nga N. R e datës 27.03.2025 për B.M dhe I.I; Emaili i datës 04.01.2025; Kopje e letërnjoftimit e ankuesit; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 22.04.2025; Kërkesë nga kryesuesi i ARKEP-it e datës 31.01.2025 për Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike; Emaili nga ARKEP i datës 04.01.2025; Listat e pagave dhjetor 2024, janar, shkurt, mars

2025; Kopje e diplomës së ankuesit e datës 23.07.2015, Kopje e diplomës së ankuesit e datës 26.12.2013; Certifikatën nëntor 2023; Vërtetim i kursit të gjuhës angleze e datës 05.06.2017 për ankuesin; Kopje e Diplomës e datës 17.07.2007; Vërtetimin e datës 06.02.2013 me Nr.15/2013; Vërtetimin e punësimit i datës 07.17.2017; Kontratë Pune e datës 12.10.2015; Kontratë Pune e datës 30.03.2016; Kontratë Pune e datës 01.04.2019; Kontratë Pune e datës 05.08.2019; Kontratë Pune e datës 05.07.2022; Kontratë Pune e datës 10.02.2023; Vërtetim nga B.M e datës 04.10.2023; Vërtetim i datës 08.10.2015; Pasqyrë e trustit; Letër Rekomandimi e datës 10.09.2024; Letër Rekomandimi e datës 13.09.2024, Raport i vlerësimit të stafit akademik 2022/2023; Raport i vlerësimit të stafit akademik 2023/2024; Vërtetim i datës; 02.12.202; Konfirmim për përfundimin e konkursit e datës 29.11.2024; Konkurs me Nr. referencës RN00014896 e datës 22.08.2024; Konfirmim për përfundimin e konkursit e datës 22.08.2024 me Nr.referncës RN00014896; Raport nga Kryesuesi ARKEP I.F, për N.R e datës 28.03.2025, 1/10, Venim i date 15.05.2025 me Nr. Protokolli 3182/2025 për zgjatjen e afatit të shqyrtimit të ankesës së ankuesi..

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesve, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi është i punësuar si nëpunës civil në Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 01.12.2024, ushtron pozitën "Zyrtar i Lartë për siguri dhe Integritet të rrjetave të Komunikimeve Elektronike.

Sipas Vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është aprovuar lista e ekspertëve të përcaktuar sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, sipas Raportit të punës të Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, për Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare janë njohur këto sisteme: *Sistemi Nacional për Monitorimin e Spektrit (SNMS); Sistemi për Monitorimin e Kualitetit të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike; Sistemi për Menaxhimin e Resurseve Frekuencore Sistemi i CERT-it Nacional (KOS-CERT)/Incident Response/Cyber Threat Intelligence.*

Tutje nga provat e kësaj çështje juridike-administrative del së kryetari i Bordit të ARKEP, më datë 31.01.2025, i është drejtuar Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, lidhur me listën e ekspertëve, ka kërkuar që edhe pozita e ankuesit të përfshihet në kudër të listës së ekspertëve, ndërsa ankuesi më datë 25.02.2025 ka parashtruar kërkesë tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për përfshirje të pozitë së tij në listën e Ekspertëve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, si Ekspert 4, Klasa B4 dhe koeficient 14, por që sipas thënieve në ankesë dhe provave të lëndës, ankuesi nuk ka pranuar përgjigje.

Ankuesi në ankesën e parashtruar ë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Këshilli ta detyroj Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, që të rekomandoj në Qeverisë ë Kosovës që pozitën Zyrtar i Lartë për Siguri dhe Integritet të Rrjetave të Komunikimeve Elektronike, ARKEP, ta përfshij në nivelin e ekspert 4, më klasë B4, me koeficient 14, sipas shtojcës 14.4 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publikë, duke kërkuar që të detyrojë Kryetarin E Bordit të ARKEP, që të ndryshoj kërkesën e datës 31.01.2025, lidhur me nivelin e ekspert 4, më klasë B4, me koeficient 14 dhe të detyroj Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike.

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, në përgjigjën në ankesë ka theksuar se: *për shkak të volumit të madh të punës që ka, Komisioni nuk ka arritur të kthejë përgjigje ndaj ankuesit për ta informuar se Komisionit nuk shqyrton kërkesa të bëra nga palët tjera, por vetëm ato që dërgohen nga zyrtari kryesor administrativ.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit iu referuar Rregullores (QRK) Nr. 22/2024 për Ekspertët, ku më nën 5 paragrafi 1, ka përcaktuar se: *1. Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit i cili vlerëson se institucioni është pronar, menaxhon dhe administron sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, ose koordinon funksionimin e këtyre sistemeve, parashtron kërkesë për vlerësim të sistemit tek Komisioni...*” dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor Kolegji konton se kërkesat për vlerësim dhe përfshirje të sistemeve përkatëse si sisteme të rëndësisë strategjike, duke përfshirë edhe pozita e caktuar që janë të nevojshme për menaxhim dhe administrativ të këtyre sistemeve, parashtrihen vetëm nga Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit gjegjes, ndërsa, në rastin konkret ankuesi personalisht më datë 25.02.2025 ka parashtruar kërkesë tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, andaj, mbi këto rrethana Kolegji vlerëson se ankuesi nuk ka legjitimitetin e palës së autorizuar që të parashtroj kërkesë pranë Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, pasi që, siç u tha më sipër kërkesat ndërlidhur me sistemet strategjike parashtrihen vetëm nga Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit.

Kolegji i Këshillit bazuar në rrethanat si më sipër, vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit për të detyruar Kryetarin e Bordit të ARKEP, që të ndryshoj kërkesën e datës 31.01.2025, lidhur me nivelin e ekspert 4, më klasë B4, me koeficient 14 dhe për të detyruar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, që pozitën e ankuesit ta klasifikoj në nivelin Ekspert 4, Klasa B4, Koeficientit 14 të e kategorizoj në listën e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, nuk janë të bazuara ligjërisht, ngase sipas Rregullores (QRK) Nr. 22/2024 për Ekspertët, është përgjegjësi e ZKA të parashtroj kërkesë tek komisioni përkatës siç p[parashihet me nenin 5 të kësaj rregulloreje, ndërsa komisioni përkatës në pajtim me nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 22/2024 për Ekspertët, janë përcaktuar përgjegjësit e komisionit.

Kështu që bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.576/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.M;
- Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komisionit me Rëndësi Strategjike në ZKM;
- Zyrtarit Kryesor Administrativ në Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.